

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi e Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarit S.E. nga Gjilani, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit S.E., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.81/2017 datë 10.05.2017 në seancën e kolegjit të mbajtur me 07.07.2017 mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit S.E., ashtu që aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.81/2017 datë 10.05.2017, vërtetohet.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.81/2017 datë 10.05.2017, e ka shpallur fajtor të akuzuarin S.E., për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, për çka e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 250 euro. I është shqiptuar dënimi plotësues – konfiskimi i armës së zjarrit – revole e tipit “Zorki”, M-906, me numër serik 002194. E ka obliguar që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogaris përfundimtare të gjykatës dhe 25 euro në emër të paushallit gjyqësor.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

- Mbrojtësi i të akuzuarit S.E. av. B.I., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën ashtu që ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë dhe ti shqiptojë një dënim me të ulët se ky i shqiptuar në këtë rast.

- Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.299/2017 të dt. 21.06.2017 ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit S.E. av. B.I. të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa është e pa bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin

sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesa është e pa bazuar. Mbrojtësi në ankesën e tij nuk thekson rrethana të cilat nuk janë vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë apo të cilat e njëjta nuk i ka pas të njohura por vetëm thekson se ka pasur hapësirë që gjykata të bëj një vlerësim më të favorshëm të rrethanave lehtësuese për të krijuar bazën ligjore për shqiptimin e një dënimi më të butë duke pas parasysh pranimin e fajësisë. Kjo gjykatë vlerëson se duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese të cilat drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë siç janë pranimi i fajësisë, keqardhja , sjelljet e mira në gjykatë si dhe premtimi se në të ardhmen nuk do të kryej vepër penale, dënimi i shqiptuar është në harmoni të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
PAKR.nr.309/17, më 07.07.2017

Procesmbajtësi,

Kryetarja e kolegjit- gjyqtarja

Bujar Balaj

1. Mejreme Memaj\_\_\_\_\_

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi\_\_\_\_\_

3. Have Haliti \_\_\_\_\_